



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 808 Prot

Tiranë, më 12.02. 2015

URDHËR

Nr. 74 datë 11.02. 2015

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË
DHURUESVE TË GJAKUT ”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 8 dhe 25 të ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rekomandimeve të Komitetit Kombëtar të Gjakut,

URDHËROJ

1. Miratimin e rregullores “ Për përcaktimin e përshtatshmërisë së dhuruesve të gjakut”.
2. Ngarkohen Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe bankat e gjakut në rrethe, për zbatimin e këtij urdhëri.
3. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror, për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
4. Urdhri nr.310, datë 11.07.2008 Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e përshtatshmërisë së dhuruesve të gjakut” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

